



Prishtinë: 12.07.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1011_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1791_04_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **04.06.2018**

në seancën e mbajtur më datë 12.07.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin K. Ll. nga Besiana me shifër të konsumatorit: DPR - 95354 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1791_04_18 i datës 20.04.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04.06.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se rezultati i shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.35023731 kanë theksuar se njehsori është në rregull, ka blloba shtetërore, nga ana e jashtme njehsori nuk ka dëmtime dhe kanë konstatuar se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar të matjes. Në ankesën e KESCO gjithashtu është theksuar se DMK në ZRRE vendimin e tij e nuk e bazon në raportin e kalibrimit por vetëm nga rrjedha e energjisë elektrike për muajin e njëjtë të vitit paraprak dhe vijues, e që këto konstatime nuk janë bindëse për korrigjim të konsumatorit pasi që konsumatori nuk do të thotë që patjetër duhet ta ketë shpenzimin e njëjtë në të gjitha periudhat. Në ankesën e KESCO është theksuar se konstatimin e ZRRE/DMK e rrëzon edhe krahasimi i shpenzimeve i periudhave 10/2015, 11/2015, 12/2015 (615 kWh) me të njëjtin periudhë të vitit 2016 (1567 kWh) me njehsor të ri ku shihet se konsumatori me njehsor të ri ka rritur shpenzimin. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së nr.ZRRE/DMK_V_1791_04_18 i datës 20.04.2018 për konsumatorin K. Ll. me shifër DPR - 95354.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.07.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit nr. 1520623 të datës 17.05.2016 nuk përputhen me shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në CCP për periudhën prill 2016. Pra Bordi i ZRRE konstaton se punëtorët e autorizuar të KEDS-it nuk kanë inspektuar saktë pikën matëse të konsumatorit përkatësisht gjendja e shpenzimeve të regjistruara në njehsor është e gabuar. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 01.07.2016 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.35023731 me gjendje TL=010048 kWh dhe TU=005219 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.64690475 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Bazuar në shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit për njehsorin elektrik nr.35023731 konstatohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në CCP për periudhën qershor 2016 përputhen me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse si dhe pajisjet të cilat i ka poseduar konsumatori në momentin e inspektimit. Pra Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë procesverbaleve të KEDS-it ka vërejtur se në procesverbalin e KEDS të datës 17.05.2016 gjendja e njehsorit elektrik nuk përputhet me gjendjen e rrjedhës së energjisë, ndërsa në procesverbalin tjetër të ndërrimit të njehsorit përputhet me gjendjen e rrjedhës së energjisë elektrike.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të paditësit KESCO lidhur me atë se njehsori elektrik gjatë shqyrtimit nga ana e kalibrimit është konstatuar se është në brenda kufijve të matjes, Bordi i ZRRE-së thekson punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit me datë 23.08.2016 kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes të njehsorit elektrik nr.35023731, ku kanë konstatuar se: *“Njehsori elektrik është në rregull, njehsori elektrik ka vulat (bllombat) shtetërore, tarifa e parë dhe tarifa e dytë është në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe kanë konstatuar se gabimi në matje është +0.21%”*.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se nuk duhet të merret parasysh krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike kjo nuk qëndron sepse shpenzimi i energjisë elektrike është indikacion mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e lëndëve të konsumatorëve, dhe se edhe KESCO është bazuar vetëm në procesin e kalibrimit. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike dhe sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik-kontestues nr.35023731 dhe njehsorin e ri elektrik nr.64690475 për periudha të njëjta kohore, konstatohet se konsumatori nuk ka ndryshim të shpenzimeve të energjisë elektrike. Për të paraqitur sa me qartë shpenzimet e konsumatorit është bërë analizimi i konsumit të energjisë së konsumatorit për periudha të njëjta kohore: me njehsorin elektrik nr.35023731 prej periudhës 03/2014 deri në periudhën 12/2014 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është **329 kWh/muaj**, si dhe periudhën 01/2015 deri në periudhën 12/2015 mesatarja mujore e shpenzimit është **304 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 64690475 për periudhën 01/2017 deri në periudhën 12/2017 mesatarja mujore e shpenzimit është **305 kWh/muaj**. Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike ka vërejtur se konsumatori nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë krahasuar me të gjitha periudhat e tjera me njehsorin kontestues, por vetëm në periudhën 02/2016 deri në periudhën 06/2016, ku vërehet qartë se ka shpenzim me të lartë. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë me njehsorin elektrik nr.35023731 për periudhën 02/2015 deri në periudhën 06/2015 është **171 kWh/muaj**, si dhe periudhën 02/2016 deri në periudhën 06/2016 është **1,501 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.64690475 për periudhën 02/2017 deri në periudhën 06/2017 mesatarja mujore e shpenzimit është **240 kWh/muaj**. Me këtë vërtetohet se konsumatori për periudhën **02/2016** deri më **06/2016** ka rritje të shpenzimit prej **776%** krahasuar me periudhën **02/2015** deri më **06/2015**, si dhe **525%** krahasuar me periudhën **02/2017** deri më **06/2017**. Pra Bordi i ZRRE duke pasur parasysh këtë ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike konstaton se shpenzimi i energjisë elektrike i faturuar për periudhat **02/03/04/05/06/2016** nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit, andaj si rrjedhojë vendimi i



organit të shkallës së parë me është kërkuar që të anulohen faturat e periudhës **02/03/04/05/06/2016** dhe konsumatori për atë periudhe të faturohet me shpenzimet e periudhës **02/03/04/05/06/2017** me njehsorin elektrik nr.64690475, është vendim i saktë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.07.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit K. Ll. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.